



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 12.09.2018

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KFW FRANKFURT AM
MAIN (KFW), PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS SË
ENERGJISË, FAZA II”**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.09.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KFW Frankfurt AM MAIN (KFW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efijencës së energjisë, faza II”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministria e Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Dorina Çinari dhe përfaqësues të kësaj ministrie si dhe zëvendësministria e Financave dhe Ekonomisë znj. Dajna Sorensen dhe përfaqësues të të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim, ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *KFW Frankfurt AM MAIN (KFW)*, për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II, nëpërmjet një granti në vlerën prej 2 032 179.23 euro.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje propozohet në vijim të marrëveshjes qeveritare të nënshkruar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjitike, faza II”, e cila është ratifikuar nga Kuvendi me anë të ligjit nr.94/2017.

Për të siguruar realizimin e programit përkatës dhe fillimin e zbatimit të marrëveshjes qeveritare nevojitet lidhja e marrëveshjes financiare me KFW, si institucioni financiar i ngarkuar nga qeveria gjermane për akordimin dhe zbatimin e financimeve që sigurohen në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve.

Ky financim me grant do t’i bashkohet një financimi tjetër të dakordësuar me qeverinë gjermane në vlerën prej 4 500 000 eurosh ku marrëveshja përkatëse qeveritare është lidhur dhe ratifikuar gjatë vitit 2016.

Financimi shtesë që akordohet me anë të marrëveshjes bashkëlidhur këtij projektligji (e cila emërtohet si fazë e dytë vetëm për arsye të koncepteve të palës gjermane mbi alokimin e fondeve nga vite të ndryshme buxhetore) vjen si rezultat i bisedimeve qeveritare mbi bashkëpunimin për zhvillim të mbajtur po në vitin 2016, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj gjermane, ku qeveria gjermane propozoi të shtojë shumën e financimit për ta bërë investimin më të plotë.

Qëllimi i programit është rehabilitimi i konvikteve të Universitetit të Tiranës, në funksion të rritjes e efikasitetit të energjisë dhe përmirësimi i kushteve të studentëve sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr.3, 14, 16, 17 dhe 18. Së bashku me rehabilitimin energjetik të ndërtesave, parashikohet të ndërmerren edhe masat themelore të komfortit në mënyrë që të përmirësohet jeta dhe mjedisi i të mësuarit për studentët, sipas kushteve të vendosura nga ligji nr.116/2016 “Për performancën e energjisë në ndërtesa”.

Objektivat e këtij projekti lidhen me komponentët e mëposhtëm:

- Auditimin energjetik të ndërtesave për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë.
- Identifikimi i nevojave të rinovimit të ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre me qëllim për të zgatur ciklin e jetës së ndërtesave.
- Identifikimi i masave të ndryshme të efikasitetit të energjisë që mund të aplikohet, si dhe llogaritja e kursimit të energjisë në secilën prej godinave.
- Reduktimi i konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së studentëve.

- Llogaritjen e reduktimit të karbonit si rezultat i masave dhe vendosjes në kushte të performancës së lartë bazuar në standardet e Bashkimit Evropian.

Ky projekt është në përputhje me Strategjinë për zhvillimin e sektorit energjetik ku pjesë e analizës janë dhe ndryshimet shumë të domosdoshme në lidhje me rritjen e sigurisë për furnizimin me energji dhe optimizimin e burimeve të energjisë, me qëllim përmbushjen e kërkesës dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm në të ardhmen.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e projektit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila do të bashkëpunojë ngushtë me Bashkinë e Tiranës, si institucioni që ka në përgjegjësi administrimi konviktet, dhe me administratën e shoqërisë studentore Universitare të Tiranës.

Projekti parashikohet të fillojë në vitin 2018 dhe do të zgjasë nga 18 deri në 24 muaj.

Kostoja e projektit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë vlerësohet në shumën prej 7.8 milionë eurosh, e cila do të financohet nga:

a) KFW-ja me anë të granteve në shumën totale prej rreth 6.5 milionë eurosh (rreth 2 milionë euro nëpërmjet marrëveshjes aktuale të financimit dhe 4.5 milionë euro me anë të një marrëveshjeje tjetër financimi);

b) buxheti i shtetit i cili do të mbulojë TVSH-në dhe kostot lokale të projektit, kosto këto të parashikuara në shumën totale prej 1.3 milionë eurosh.

Shuma e grantit nuk do të përdoret për mbulimin e kostove që mund lindin nga pagesa e taksave dhe detyrimet e tjera publike që mund të krijohen nga përfituesi i grantit dhe taksat doganore për importet.

Marrëveshja u miratua, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr.750, datë 13.12.2017, u nënshkrua ndërmjet palëve dhe po i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Anëtarët e Komisionit vlerësuan rëndësinë e projektligjit, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e furnizimit me energji, reduktimin e humbjeve e të kostove dhe rritjen e efikasitetit të energjisë në kampusin universitar të Tiranës. Njëkohësisht u kërkuar sqarime në lidhje me marrëveshjen tjetër të financimit, që parashikohet të lidhet me KFW dhe efektet që do të ketë kjo e fundit në rehabilitimin e konvikteve. Nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u sqarua se aktualisht po negociohet me KFW për akordimin e një fondi shtesë me qëllim rehabilitimin e dy konvikteve të tjera në Kampusin Universitar të Tiranës.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ADNOR SHAMETI

ULSI MANJA